



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AC-AKP nr.01/2024

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarëve, Ragip Namani kryetar i kolegjit, Beshir Islami dhe Nenad Lazić, anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Zanë Buçinca, procesmbajtëse, në çështjen juridike **të palës ankuese;**

B.K., nga P., rr. “Q.B”., ,Hy..., nr., sipas autorizimit e përfaqëson, Qendrim Arifaj, avokat me seli në Prishtinë, rr.”Tringë Smajli” Hy. 10.nr.6.

Kundër:

Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, (tutje, AKKVP), me seli në Prishtinë.

Duke vendosur lidhur me Ankesën e paraqitur, nga i autorizuari lartë cekur, kundër Vendimit Përfundimtar të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës, (tutje KKPK), me nr. KPCC/D/COMP/01/2019 të datës 27 shtator 2019, dhe kundër Vendimit të Komisionit për Çështje Pronësore Banesore, (tutje; KÇPB),nr. HPCC/REC/85/2006C, të datës, 11 Dhjetor 2006, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë, 15 Gusht 2024, merr:

A K T V E N D I M

Hedhet poshtë si e papranueshme Ankesa e ushtruar nga B.K., kundër Vendimit Përfundimtar të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës, me nr. KPCC/D/COMP/01/2019, të datës 27 Shtator 2019, dhe kundër Vendimit të Komisionit për Çështje Pronësore Banesore, nr. HPCC/REC/85/2006C, të datës, 11 Dhjetor 2006.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike;

Nga ankesa e palës ankuese, akteve të bashkangjitura të njëjtës, si dhe vendimeve dhe akteve të bashkangjitura lëndës të pranuar nga AKKVP, rezulton se; Drejtoria për Çështje Pronësore Banesore, përkatësisht Komisioni i shkallës së dytë për Kërkesa Pronësore Banesore, (tutje KKPB), i këtij organi, me Vendimin e vërtetuar (përfundimtar), nr. HPCC/REC/85/2006C, të datës, 11 Dhjetor 2006, të nxjerrë në pajtim me nenin 22.9, të Reg. 2000/60 mbi kërkesën në rishqyrtim të paraqitësit të kërkesës **DS.....** Xh.G., dhe palës përgjegjëse R.S, kërkesa nr., ka vendosur, me urdhër që:

Kërkesa për rishqyrtim të aprovet dhe **Vendimi i Komisionit nr. HPCC/D/180/A&C, i datës 30 Prill 2005, të ndryshohet në atë masë sa ka të bëjë me këto dy kërkesa dhe vendos si në vijim;**

Pika a), kërkesa e kategorisë, “A”, nr. **DS....**, e palës kërkuese, Xh.G., aprovet dhe atij i kthehet e drejta e pronësore në banesën lëndore, e cila gjendet në P.,,, Banesa ...në sipërfaqe prej 81.43m².

Pika b)., kërkesa e kategorisë “C”, nr. **DS.....**, e palës përgjegjëse R.S., që (sipas komisionit ka sjell dëshmi të mjaftueshme në Drejtorat se e ka ri-paguar çmimin blerës të cilin e kishte pranuar nga banuesi aktual sipas marrëveshjes së pavlefshme mbi shitjen në mes tyre), me vendimin e njëjtë komisioni vendos ti ipet e drejta dhe ti kompensohet si në kuptim të nenit 4, të Rreg. Nr 2000/60, një shumë e paguar për blerjen e pronës, plus përqindja e vlerës aktuale të pronës në treg,(shih parag.(B), të vendimit të njëjtë).

Sipas Ligjit 05/L-010, AKKVP, për veç mandatit kryesor të saj, ka trashëguar një pjesë të përgjegjëse dhe të mandatit të Agjencisë Kosovare të Pronës dhe të Drejtorisë për Kërkesa Pronësore dhe Banesore, **(kësaj të fundit kryesisht lidhur me implementimin e vendimeve të sajë të plotfuqishëm), ashtu si parashihet në nenet 17-19, dhe 22.5, të këtij ligji.**

AKKVP, bazuar në kornizën ligjore, dispozitat e Ligjit nr. 05/L-010, dhe në pajtim me nenin 10 (9) të U.A.10/2018, të Qeverisë së Republikës së Kosovës për procedurën e skemës së kompensimit për zbatimin e vendimeve të Komisionit për Kërkesë Pronësore Banesore,(KKPB) me datë 27 shtator 2019, merr Vendimin e vërtetuar grupor nr. KPCC/D/COMP/2019 dhe vendimin përfundimtar, me të cilin paraqitësit të kërkesës DS, Xh.G., i aprovet pronësia mbi pronën e kërkuar (adresa e pronës “.....- kati . nr. .. P), dhe urdhëron që prona lëndore të regjistrohet në shënimet publike përkatëse. Pala përgjegjëse nëse ka ndonjë dhe qdo person tjetër i cili e ka uzurpuar pronën, ta liroj atë brenda afatit prej 30 ditë nga dita e pranimit të këtij urdhri, dhe nëse pala përgjegjëse apo personi tjetër që e ka uzurpuar pronën dështon ta liroj brenda afatit të caktuar të dëbohet nga prona.

Kundër vendimeve të cekura si më lartë, Vendimit Përfundimtar të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës, me nr. KPCC/D/COMP/01/2019, të datës 27 Shtator 2019, dhe kundër Vendimit të Komisionit për Çështje Pronësore Banesore,(tutje; KÇPB),nr. HPCC/REC/85/2006C, të datës, 11 Dhjetor 2006, pala ankuese B.K., për mes përfaqësuesit sipas autorizimit, Avokat Qendrim Arifaj, ushtron ankesë në Gjykatë Supreme me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtëve për shkak se; Vendimet bazohen në fakte jo të plota dhe në vlerësimin e gabuar të fakteve. Në arsyetim ankesës e paraqet në mënyrë kronologjike zhvillimin e kësaj procedure në KKP, dhe në AKKVP sipas kërkesave të palëve DS.... të Xh.G., dhe DS, të R.S., duke theksuar ndër të tjera se, AKKVP vendimin e saj grupor e ka nxjerr pa e arsyetuar se mbi bazën e cilave prova e ka aprovuar kërkesën DS dhe ka konstatuar se Xh.G., ka qen edhe më parë në pronësi të pronës kontestuese, se kjo pronë i ka takuar R.S., e cila fillimisht i ishte ndarë me qira në vitin 1991, nga JP “E. K”. , i cili më vonë e ka privatizuar-blerë në vitin 1993, nga Ndërmarrja Publike dhe Termocentrali Kosovë, se banesën e njëjtë në vitin 2004 e ka trashëguar D.S., e cila në vitin 2005, ja ka shitur M. K., sipas kontratës së shitblerjes të vërtetuar para hyrjes në fuqi të Rreg. 2006/60, për deri sa më vonë M. K., ka lidh kontratë të vërtetuar në gjykatë me vëllain e tij B .K., mbi faljen e kësaj prone i cili prej viti 2005 e ka

në shfrytëzim të ligjshëm, për deri sa pala tjetër nuk ka dokumente se i është ndarë kjo banesë nga ish punëdhënësi dhe ai nuk ka qen asnjëherë titullar apo shfrytëzues i saj. Në fund propozon që Gjykata Supreme pas vlerësimit të pretendimeve ankimore dhe provave të bashkangjitura të merr aktgjykim me të cilin aprovohet në tërësi ankesa e palës ankuese B.K., , të anulohen Vendimi Përfundimtar të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës, me nr. KPCC/D/COMP/01/2019, të datës 27 Shtator 2019, dhe Vendimi mbi kërkesën për rishqyrtim HPCC/D/85/2006/A&C, i datës 11.12.2006 , të vërtetohet Vendimi HPCC/D/180/2005/A&C i dt. 30.04,2005 ashtu që i njihet pronësia B.H. K., mbi banesën e cila gjendet në Prishtinë, “B.D” ,....kati, ., nr.

Arsyetimi ligjor;

-Juridiksioni,

Gjykata Supreme, kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e lëndëve sipas ankesës të ish Agjencisë Kosovare të Pronave, tani Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të tjera të paraqitura nga pala ankuese gjen se, kjo gjykatë nuk ka kompetencë ligjore për të vendosur lidhur me Vendimet e ish Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore, dhe as Vendimeve të AKKVP që janë të ndërlidhura me zbatimin, (implementimin), e vendimeve të këtij organi, si në rastin konkret të Vendimit të Komisionit për Çështje Pronësore Banesore, nr. HPCC/REC/85/2006C, të datës, 11 Dhjetor 2006 dhe Vendimit Përfundimtar të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës, me nr. KPCC/D/COMP/01/2019, të datës 27 Shtator 2019.

Në kuptim të nenit 15.1, të Ligjit në fuqi nr.05/-L-010 për AKKVP, kundër vendimit të Komisionit për Verifikim dhe Vendosje të Pronës, dhe kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore, palët brenda afatit prej 30 ditë, mund të paraqesin ankesë në Gjykatën Supreme për mes Sekretarisë së Agjencisë.

Megjithatë sipas këtij Ligji, (nr.05/-L-010), nuk është e paraparë që vendimet e ish Drejtorisë për Çështje Pronësore dhe Banesore, përkatësisht Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore apo aktet e tjera të më vonshme të nxjerrë nga AKKVP, si në këtë rast Vendimi Përfundimtar i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës, nr. KPCC/D/COMP/01/2019, të datës 27 Shtator 2019, lidhur me zbatimin këtyre vendimeve, se mund të jenë objekt i kontestimit qoftë me padi apo me ankesë në Gjykatë Supreme, për deri sa sipas neneve 17-19, dhe nenit 22. 5, të këtij ligji, si dhe rregullave dhe procedurave të përcaktuara sipas Udhëzimit Administrativ, QRK nr. 10/2018, i nxjerrë nga Qeveria e Republikës së Kosovës për Procedurat e Skemës së Kompensimit për Zbatimin e Vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore,(neni 3.1.12, dhe neni 10 parag. 8,9,12, i këtij U.A), AKKVP ka kompetencë të ekzekutoj, vendimet e plotfuqishme të Komisionit për Kërkesa Pronësore, aktgjykimet e Gjykatës Supreme, dhe **Vendimet e Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore, (HPCC), në zbatim të nenit 4 të Rregullores së UNMIK, nr. 2000/60**, dhe të bëjë lëshimin dhe ekzekutimin e urdhrin për dëbim, të çdo personi që është duke qëndruar në mënyrë të pa ligjshme në një pronë, të vendosur me vendim të plotfuqishëm të Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore (KKPB).

Sipas nenit 2.7, të Rregullores së UNMIK, nr.1999/23, të datës 15 Nëntor 1999, Vendimet e Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore, janë të detyrueshme për tu zbatuar **dhe nuk janë objekt i ri i shqyrtimit nga asnjë organ tjetër gjyqësor apo administrativ në Kosovë.**

Vendimi vërtetuar mbi kërkesën në rishqyrtim i shkallës së dytë nr. HPCC/D/85/2006C i datës 11 Dhjetor 2006, me të cilin është ndryshuar vendimi i shkallës së parë HPCC/180/2005/A&C, i dt. 30.Prill 2005, është i plotfuqishëm, andaj në pajtim me nenin 2, paragraf 7, të Rregullores së lartë cekur, nr. 1999/23, i njëjti nuk mund të ankimohet, as sipas Rregullores së UNMIK nr.2000/60, sepse dispozitat e këtyre Rregulloreve si më lartë, në fuqi në kohën e vendosjes së kësaj çështje, si dhe aktet ligjore të më vonshme dhe tani në fuqi që e rregullojnë këtë lëmi, nuk parashohin ndonjë mjet juridik të rregullt apo të jashtëzakonshëm të goditjes ndaj vendimeve përfundimtare të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore.

Sipas dispozitave të Rregullores së lartë cekur, nr. 1999/23, pas vendosjes nga Komisioni për Kërkesa Pronësore Banesore me vendim, i cili është bërë i formës së prerë, çështja e vendosur trajtohet *res judicata*, sepse sipas nenit 2.5, të kësaj Rregullore, në çështjet e pronave banesore, juridiksioni i gjykatave lokale ishte përjashtues, ndërsa komisioni ka kompetenca ekskluzive për të zgjidhë kategoritë e kërkesave të theksuara si në nenin 1.2, të kësaj Rregullore.

Ngjashëm është edhe jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, sa u përket vendimeve të formës së prerë të Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore, (shih Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, në rastin **me numër, KI 104/10**, e në mënyrë specifike paragrafët, 64-75, të këtij aktgjykimi).

Nga të lartë cekurat e në kuptim të nenit 16.3, parag.3.2, të Ligjit 05/L-010, për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Sipas nenit 16.6, të Ligjit 05/L-010, ky aktvendim është i formës së prerë dhe i plotfuqishëm, i njëjti nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË
AC-AKP nr. 01/2024, me datë 15 Gusht 2024

Bashkp. Profesionale,
Zanë Buçinca

Kryetari i Kolegjit,
Ragip Namani